

## NJOFTIM PUNE

**Profili i kompanisë:** Balkan Finance Investment Group është një ndër grupet private investuese më të mëdha në Shqipëri dhe rajon, i pranishëm me aktivitete për zhvillimin e pasurive të paluajtshme, shitjet me pakicë, ofrimin e shërbimeve dhe menaxhimin e hapësirave tregtare apo industriale, industri minerare, financime dhe programe besimi për konsumatorët. ACREM sh.p.k është pjesë e Balfin Group e specializuar në ofrimin e menaxhimit të pasurive të paluajtshme të Balfin Group dhe jo vetëm, si dhe shërbimeve operative në to.

**Pozicioni:** Brand & Communications Coordinator

**Departamenti:** Marketing

**Vendodhja:** TEG/ ACREM

### **Përshkrim i Pozicionit të Punës:**

Brand & Communication Coordinator në një Qëndër Tregtare është personi përgjegjës që zhvillon dhe konkretizon planet marketing të qendrës në përputhje me objektivat e kompanisë si dhe monitoron implementimin e tyre. Ndjek dhe zhvillon kalendarin vjetor të marketingut për realizimin e fushatave publicitare dhe kryen një sërë detyrash me kërkesë të gjerë kreativiteti dhe objektiva të mirëpërcaktuar për të cilat kërkohet një kombinim eksperience dhe gjykim i fortë. Raporton tek Menaxheri i Marketingut.

### **Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Të ndërtojë planet e fushatave sipas sezonaliteteve dhe specifikave, të vlerësoj buxhetin përkatës në secilin rast dhe të implementoj planin me taktikat përkatëse për performancën e suksesshme të qendrës tregtare.
- Të analizojë fushatat dhe të ndërmarrë veprime sipas situatave që paraqiten me qëllim arritjen e rezultatit final.
- Të definoj kanalet e komunikimit sipas fushatës dhe të aplikoj ndarjet e buxheteve, përkatësisht me fokus të veçante dhe njohje shumë të mirë të mediave sociale.
- Të koordinojë fushatat marketing me shitjet e dyqaneve dhe të rris performancën e dyqaneve të qendrës.
- Të bashkëpunojë me kanale të ndryshme mediatike sipas planit të kompanisë dhe në linje me politikat e grupit.
- Të mbaj marrëdhënie me kompani të ndryshme, partnerë, për projektimin dhe realizimin e aktiviteteve të ndryshme në qendër, duke siguruar përherë zhvillime të reja dhe të kohës.
- Të organizojë evente argëtuese dhe angazhuese për klientët e qendrës, duke sjellë propozime, ide të reja të cilat duhet të ndiqen deri në implementim.
- Të ketë qasje novatore, të njoh sektorin dhe zhvillimet ndërkombëtare që përcaktojnë të ardhmem e qendrave tregtare.
- Të menaxhojë gjithë dokumentacionin e detajuar të fushatave në përputhje me politikat e grupit.
- Të monitorojë aktivitetin e konkurrencës.

**Kërkesat e pozicionit të punës:****Edukimi:**

- Diplomë ne Administrim – Biznes, Profili Marketing
- Studimet Master - Profili Marketing dhe trajnimet në këtë fushë përbëjnë avantazh.

**Eksperiencat e punës:** Jo më pak se 5 vjeçare në fushën e marketingut.

**Kualifikime të tjera:**

- Trajnime të ndryshme në lidhje me marketingun online.
- Të ketë njohuri shumë të mira në gjuhën angleze (në të folur & shkruar)
- Preferohet të zotëroje gjuhën Italiane, ose një gjuhë tjetër të BE

**Aftësi të tjera:**

- Të ketë aftësi shumë të mira të komunikimit dhe të bashkëpunimit në grup.
- Të ketë aftësi shumë të mira organizative.
- Të jetë person energjik dhe me vetëmotivim të lartë ne punë.
- Të ketë iniciative për ide /risi ne fushën marketing.
- Të ketë aftësi dhe pavarësi në vendimarrje brënda kompetencave të pozicionit.
- Të ketë aftësi shumë të mira ndërpersonale.

**Mënyra e aplikimit:** Për të aplikuar për këtë pozicion, ju lutem dorëzoni dokumentet e më poshtme:

- CV të Detajuar
- Letër Interesi,

tek zyrat qendrore të ACREM nëpërmjet njërës nga mënyrat si në vijim:

1. Me e-mail: [hr@acrem.al](mailto:hr@acrem.al)
2. Duke dërguar me postë në adresën e më poshtme:  
Qendra Tregtare TEG, Rruga Nationale Tiranë-Elbasan, Farkë, Lundër, Tiranë, Shqipëri.

**Afati i dorëzimit:** Deri më **30 Nëntor 2019**

*\*Të gjitha aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet të plotë sipas ligjit Nr 9887 vendosur nga Kuvendi i Shqipërisë për “Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.*